

Врз основа на член 55 став 1 од Законот за организација и работа на органите на државната управа („Службен весник на Република Македонија“ бр. 58/00, 44/02, 82/08,167/10 и 51/11) и член 22 став 1 од Законот за средното образование („Службен весник на Република Македонија“ бр. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 и 64/18), министерот за образование и наука ја донесе наставната програма по наставниот предмет **хемија** за **I (прва) година** образование од средното стручно образование со четиригодишно траење.

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT**



**Programi mësimor**

**KIMIA**

**dizajn modular**

**për vitin I**

**profili arsimor/kualifikimi**

Teknik i gjeologjisë-xehetarisë, Teknik i metalurgjisë, Teknik i grafikës, Redaktor-dizajner i grafikës, Teknik i përkujdesjes kozmetike dhe bukurisë, Teknik i mobilieve dhe enterierit, Teknik i përpunimit të drurit, Teknik i modelimit të këpucëve, Teknik pyjor, Teknik i dizajnit të peizazhi, Teknik i dizajnit të veshmbathjes, Teknik i modelimit të veshmbathjes, Teknik i këpucëve, Teknik i modelimit të këpucëve, Teknik i përpunimit të veshmbathjes, Teknik i mjekësisë laborant-sanitar, Asistent dentist, Teknik i farmacisë, Teknik fizioterapeut, Infermiere e gjinekologjisë dhe akushërisë, Infermiere, Teknik dhëmbësh, Agroteknik, Teknik i medicinës veterinare, Teknik i fitomedicinës, Teknik i agromenaxhimit

**drejtimi/ sektori**

Gjeologji-xehetari dhe metalurgji/Gjeologji, xehetari dhe metalurgji, Grafikë/Grafikë, Shërbime personale, Pylltari-përpunim i drurit/Pylltari dhe përpunim i drurit, Tekstil-lëkurë/Tekstil, lëkurë dhe prodhime të ngjashme, Mjekësi/Mjekësi dhe mbrojtje sociale, Bujqësi-veterinari/Bujqësi, peshkim dhe veterinar

**Shkup, viti 2019**

<b>Titulli i programit mësimor</b>	Kimia
<b>Lloji i programit mësimor</b>	I obligueshëm
<b>Vlera kreditore e programit mësimor</b>	3 kredi ECVET <sup>1</sup> 5 kredi ECVET (3+2, 2 kredi përshtaten me 50 orë aktivitet të nxënësit ngatë cilat 20 orë detyra shtëpi dhe 30 orë mësim i pavarur).
<b>Drejtimi</b>	Gjeologji-xehetari; Grafik; Shërbime personale; Pylltari-përpunimi i drurit; Tekstil-lëkurë; Mjekësi; Bujqësi-veterinari
<b>Sektori</b>	Gjeologji, xehetar dhe metalurgji; Grafikë; Shërbime personale; Pylltari dhe përpunim i drurit; Tekstil, lëkurë dhe prodhime të ngjashme; Mjekësi dhe mbrojtje sociale; Bujqësi, peshkim dhe veterinari.
<b>Profili arsimor</b>	(3 kredi) Teknik grafik, Redaktor-dizajnues grafik, Teknik i mobilieve dhe enterierit, Teknik i përpunimit të drurit, Teknik i dizajnit të veshmbathjes, Teknik i modelimit të veshmbathjes, Teknik i modelimit të këpucëve  (5 kredi) Teknik i gjeologjisë-xehetarisë, Teknik i metalurgjisë, Teknik i përkujdesjes kozmetike dhe bukurisë, Teknik pyjor, Teknik i dizajnit të peizazhit, Teknik i këpucëve, Teknik i përpunimit të veshmbathjes, Teknik i mjekësisë laborant-sanitar, Asistent dentist, Teknik i farmacisë, Teknik fizioterapeut, Infermiere e gjinekologjisë dhe akusherisë, Infermiere, Teknik dhëmbësh, , Agroteknik, Teknik i medicinës veterinare, Teknik i fitomedicinës, Teknik i agromenaxhimit
<b>Titulli dhe niveli i kualifikimit</b>	(3 kredi) Teknik i grafikës, Redaktor-dizajnues grafik, Teknik i mobilieve dhe enterierit, Teknik i përpunimit të drurit, Teknik i dizajnit të veshmbathjes, Teknik i modelimit të veshmbathjes, Teknik i modelimit të këpucëve  (5 kredi) Teknik i gjeologjisë-xehetarisë, Teknik i metalurgjisë, Teknik i përkujdesjes kozmetike dhe bukurisë, Teknik pyjor, Teknik i dizajnit të peizazhit, Teknik i këpucëve, Teknik i përpunimit të veshmbathjes, Teknik i mjekësisë

<sup>1</sup> Ligji për Kornizën nacionale të kualifikimeve.

	<p>laborant-sanitar, Asistent dentist, Teknik i farmacisë, Teknik fizioterapeut, Infermiere e gjinekologjisë dhe akusherisë, Infermiere, Teknik dhëmbësh, Agroteknik, Teknik i medicinës veterinare, Teknik i fitomedicinës, Teknik i agromenaxhimit.</p> <p>Niveli 4 (i katërt)</p>
<b>Viti shkollor</b>	Viti I (i parë)
<b>Numri i orëve në javë/vit për realizimin e programit mësimor</b>	2/72
<b>Qëllimet e programit mësimor</b>	<p>Nxënësi/nxënësja të fitojë dituri/aftësi/kompetenca për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- nocionet themelore kimike;</li> <li>- eksperimentin si mjet për mësimin e kimit dhe ardhja deri te zbulimet shkencore dhe të arriturat;</li> <li>- ndërtimin e materies dhe sistemit natyror të elementeve;</li> <li>- lidhjen mes vetive të substancave, ndërtimit të tyre dhe lidhjeve kimike në to;</li> <li>- llojet themelore të komponimeve inorganike;</li> <li>- zgjidhjen e detyrave të thjeshta kimike;</li> <li>- rolin e ujit, ajrit dhe plehrave për mirëmbajtjen e ambientit shëndetësor;</li> <li>- eksperimentimin;</li> <li>- evidentimin, përpunimin, prezantimin dhe sqarimin e rezultateve;</li> <li>- saktësinë, pedanterinë dhe kursimin;</li> <li>- përdorimin e burimeve të ndryshme të informatave;</li> <li>- komunikimin, punën në grupe dhe bashkëpunimin.</li> </ul>
<b>Njësitë modulare të programit mësimor</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• KIMIA SI SHKENCË EKSPERIMENTALE</li> <li>• NDËRTIMI I MATERIES</li> <li>• SISTEMI NATYROR I ELEMENTEVE</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• LIDHJET KIMIKE</li> <li>• GRUPET THEMELORE TË KOMPONIMEVE INORGANIKE</li> <li>• BAZAT E NJEHËSIEVE KIMIKE</li> <li>• KIMIA DHE AMBIENTI JETËSOR</li> </ul>
<b>Kushtet materiale-teknike dhe hapësinore</b>	Kabinet të kimisë, mjetet adekuate dhe kimikatet, pajisje kompjuterike, vizatime, fotografi, skema, modele të molekulave, modele të grilave kristalore, tekste, doracakë, praktikume, revista, enciklopedi, softuer arsimor, internet dhe mjetet tjera mësimore.
<b>Normativi i kuadrit mësimor</b>	Mësimin në lëndën e Kimisë në vitin e parë të arsimit të mesëm profesional katërvjeçar, mund ta mbajë personi i cili ka kryer: <ul style="list-style-type: none"> <li>- studime në kimi, drejtimi arsimor, VII/1 ose VIA sipas KNK dhe 240 ECTS;</li> <li>- studime në kimi, drejtim tjetër arsimor, VII/1 ose VIA sipas KNK dhe 240 ECTS, dhe me përgatitje pedagogjike-psikologjike dhe metodike të fituar në institucione të akredituara të arsimit të lartë.</li> </ul>

Njësia modulare 1: KIMIA SI SHKENCË EKSPERIMENTALE (7 orë)				
Nr. rendor	Rezultatet nga të mësuarit	Përmbajtjet dhe nocionet	Aktivitetet dhe metodat	Kriteret e vlerësimit*
1	<p><b>Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë të:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njohë rolin e eksperimentit si mjet për studimin e kimisë dhe arritja deri te zbulimet dhe arritjet shkencore, njohë dhe shfrytëzojë mjetet laboratorike dhe theksojë dhe zbatojë masat e kujdesit gjatë eksperimentimit;</li> </ul>	<p><b>Përmbajtjet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kimia si shkencë eksperimentale</li> <li>- Pajisjet laboratorike dhe masat e kujdesit</li> <li>- Eksperimentimi në kimi</li> </ul> <p><b>Nocionet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kimia</li> <li>- Teoria</li> <li>- Eksperimenti</li> <li>- Pajisja laboratorike</li> </ul>	<p><b>Aktivitetet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Diskutimi në lidhje me lëndën dhe rëndësinë e kimisë si shkencë natyrore eksperimentale.</li> <li>- Njohja me pajisjet themelore laboratorike.</li> <li>- Përpunimi i tabelave, skemave afisheve etj. Në lidhje me masat e kujdesit dhe sigurisë gjatë punës me kimikate.</li> <li>- Ushtrime: Realizimi i eksperimenteve të thjeshta me zbatimin e procedurave themelore</li> </ul>	<p><b>Nxënësi/nxënësja mund të:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- theksojë rëndësinë e eksperimentit në kimi dhe lidhë me shembuj nga jeta e përditshme;</li> <li>- theksojë, njohë dhe shfrytëzojë pajisjen themelore laboratorike;</li> <li>- njohë masat e kujdesit gjatë punës në laborator kimik;</li> <li>- zbatojë udhëzimet e sigurisë dhe vlerësojë rreziqet gjatë punës;</li> <li>- kryejë eksperimente të thjeshta dhe paraqesë</li> </ul>

\* Janë vendosur standarde/indikatorë për arritjen e rezultateve nga të mësuarit në bazë të të cilave përcaktohen kriteret e vlerësimit.

			<p>gjatë punës në laborator kimik.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Vizitë laboratorit kimik.</li> </ul> <p><b>Metodat:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Prezantimi</li> <li>– Diskutimi</li> <li>– Demonstrimi</li> <li>– Vëzhgimi</li> <li>– Eksperimentimi</li> </ul>	<p>rezultatet;</p>
2	<p>- definojë madhësi fizike dhe njësitë e tyre dhe t'i zbatojë gjatë prezantimit të rezultateve nga matja.</p>	<p><b>Përmbajtjet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Madhësitë fizike dhe sistemi ndërkombëtar i njësive</li> <li>– Matja</li> </ul> <p><b>Nocionet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Madhësia fizike (themelore dhe e fituar)</li> <li>– Njësia e madhësisë fizike</li> </ul>	<p><b>Aktivitetet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Diskutimi për madhësitë themelore dhe të fituara fizike dhe njësitë e tyre.</li> <li>– Ushtrime: shkrimi i barazimeve të madhësisë dhe shndrimi në njësi.</li> <li>– Ushtrime: Matja e masës, temperaturës, kohës dhe</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– njohë dhe numërojnë madhësitë themelore fizike dhe njësitë e tyre;</li> <li>– njohë dhe numërojnë disa madhësi të fituara fizike, si për shembull: vëllimi, dendësia etj.;</li> <li>– përdorë instrumente adekuate për matje të masës, temperaturës, kohës dhe</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Barazimi i madhësisë</li> <li>- SI (sistemi ndërkombëtar i njësive)</li> <li>- Matja</li> </ul>	<p>vëllimit me aparate/instrumente adekuate.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Prezantimi dhe interpretimi rezultateve nga matjet.</li> <li>- Diagnostikimi i gabimeve dhe parregullsive gjatë matjes.</li> </ul> <p><b>Metodat:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Prezantimi</li> <li>- Diskutimi</li> <li>- Demonstrimi</li> <li>- Llogaritja numerike</li> <li>- Eksperimentimi</li> </ul>	<p>vëllimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- prezantojë rezultatet e matjes në tabelë ose grafik;</li> <li>- nxjerrë përfundime nga matjet.</li> </ul>
--	--	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------



Njësia modulare 2: NDËRTIMI I MATERIES (14 orë)				
Nr. rendor	Rezultatet nga të mësuarit	Përmbajtjet dhe nocionet	Aktivitetet dhe metodat	Kriteret e vlerësimit *
1	<p><b>Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë të:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njohë dhe përshkruajë karakteristikat e tri gjendjeve agregate të materies, si dhe shndërrimet adekuate fazore;</li> </ul>	<p><b>Përmbajtjet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Vetitë fizike dhe kimike dhe ndryshimet fizike dhe kimike</li> <li>– Teoria e korpuskularitetit dhe gjendjet agregate të materies (e ngurtë, e lëngtë dhe e gaztë)</li> <li>– Ndryshimet e gjendjeve agregate</li> </ul> <p><b>Nocionet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Vetitë fizike</li> <li>– Vetitë kimike</li> <li>– Ndryshimet fizike</li> </ul>	<p><b>Aktivitetet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Vëzhgimi i substancave për vetitë e tyre.</li> <li>– Demonstrime: ndryshimet fizike dhe kimike të substancave.</li> <li>– Zbatimi i TIK: karakteristikat e gjendjeve agregate në nivel mikroskopik dhe mikroskopik.</li> <li>– Demonstrime:</li> <li>– Ndryshimet e gjendjeve agregate.</li> <li>– Prezantimi i rezultateve dhe përfundimet.</li> </ul>	<p><b>Nxënësi/nxënësja mund të:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– theksojë dhe njohë vetitë dhe ndryshimet te substancat e ndryshme;</li> <li>– numërojë gjendjet agregate dhe ilustrojë me shembuj të substancave nga mjedisi;</li> <li>– lidhë vetitë mikroskopike dhe mikroskopike të substancave në tri gjendjet agregate në aspektin e distancave të ndërsjella të tyre dhe lëvizjes së grimcave nga të cilat janë nderuar (zbatojë teorinë e korpuskularitetit);</li> <li>– njohë shndërrimet fazore si ndryshime fizike të materies;</li> </ul>

\* Janë vendosur standarde/indikatorë për arritjen e rezultateve nga të mësuarit në bazë të të cilave përcaktohen kriteret e vlerësimit.

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndryshimet kimike</li> <li>- Gjendja agregate</li> <li>- Shkrirja</li> <li>- Avullimi</li> <li>- Kondensimi</li> <li>- Kristalizimi (ngrirja)</li> <li>- Sublimimi</li> </ul>	<b>Metodat:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Prezantimi</li> <li>- Diskutimi</li> <li>- Demonstrimi</li> <li>- Eksperimentimi</li> </ul>	
2	- sqarojë ndërtimin e atomit dhe bëjë dallim mes atomit, molekulës dhe jonit.	<b>Përmbajtjet:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndërtimi i atomit (grimcat fundamentale, numri atomik dhe numri i masës)</li> <li>- Molekulat dhe jonet</li> </ul> <b>Nocionet:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Atom</li> <li>- Bërthama atomike</li> <li>- Mbështjellësi elektronik</li> </ul>	<b>Aktivitetet:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Diskutimi për ndërtimin e atomit.</li> <li>- Vizatimi i prezantimeve skematike të atomeve dhe joneve të elementeve të caktuara dhe përpunimi i modeleve të atomeve dhe molekulave.</li> <li>- Zbatimi i TIK: Animacioni i mikrobotës.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- numëroj grimcat më të rëndësishme fundamentale: protonet, neutronet dhe elektronet dhe njohë karakteristikat e tyre;</li> <li>- sqarojë modelin e thjeshtë të atomit duke përdorur nocione për bërthamën atomike dhe mbështjellësin elektronik;</li> <li>- definojë numrin atomik dhe të masës;</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>– Shtresat e elektroneve</li> <li>– Protoni</li> <li>– Neutroni</li> <li>– Elektroni</li> <li>– Elektronet valente</li> <li>– Numri atomik</li> <li>– Numri i masës</li> <li>– Izotopet</li> <li>– Izobaret</li> <li>– Molekula</li> <li>– Joni</li> <li>– Kationi</li> <li>– Anioni</li> <li>– Njësia e formulës</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Ushtrime: Llogaritja e numrit të protoneve, neutroneve, elektroneve, numrit atomik dhe numrit të masës të atomeve të ndryshme.</li> <li>– Prezantimet: jeta dhe vepra e shkencëtarëve kimistë të dalluar (Ernest Raderford, Nils Bor etj.).</li> </ul> <p><b>Metodat:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Prezantimi</li> <li>– Diskutimi</li> <li>– Ilustrimi</li> <li>– Demonstrimi</li> <li>– Llogaritja numerike</li> <li>– Mentorimi dhe orientimi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– përcaktojë numrin e elektroneve në shtresat elektronike në bazë të numrit atomik;</li> <li>– përcaktojë numrin e elektroneve valente dhe t'i lidhë me nocionin jon;</li> <li>– sqarojë formimin e kationeve dhe anioneve;</li> <li>– definojë dhe bëjë dallim mes llojeve të ndryshme të njësive ndërtimore: atome, molekula dhe jone;</li> </ul>
--	--	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

3	<p>- bëjë dallim mes elementit, substancës elementare, komponimit dhe përzierjes dhe njohë procedurat për ndarjen e komponentëve nga përzierja.</p>	<p><b>Përmbajtjet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Elementet, substancat elementare (metalet, jometalet dhe semimetalet) dhe komponimet</li> <li>- Përzierjet (homogjene dhe heterogjene)</li> <li>- Procedura për ndarjen e komponentëve nga përzierja</li> </ul> <p><b>Nocionet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Element</li> <li>- Substanca elementare</li> <li>- Metali</li> <li>- Jometali</li> <li>- Semimetali</li> <li>- Komponimet</li> <li>- Përzierja (homogjene dhe</li> </ul>	<p><b>Aktivitetet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Diskutimi për nocionet: element, substanca elementare, komponimet, përzierja.</li> <li>- Ushtrimet eksperimentale: Vëzhgimi dhe identifikimi i vetive të substancave të ndryshme; fitimi i komponimeve nga substancat elementare; zberthimi i komponimeve të substancave elementare; përgatitja e përzierjeve; ndarja e komponentëve nga përzierja.</li> </ul> <p><b>Metodat:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Prezantimi</li> <li>- Diskutimi</li> <li>- Vëzhgimi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- definojë nocionet për elementin, substancën elementare, komponimin dhe përzierjen dhe japë shembuj;</li> <li>- interpretojë nëpërmjet shembujve rëndësinë e nocioneve të dhëna;</li> <li>- bëjë dallim të qartë mes nocioneve: element, substanca elementare dhe komponim;</li> <li>- dallojë përzierjen homogjene nga ajo heterogjene;</li> <li>- zbatojë teorinë e korpuskulartetit gjatë identifikimit të substancave elementare, komponimeve dhe përzierjeve;</li> <li>- përdorë procedura për ndarjen e komponentëve nga përzierja.</li> </ul>
---	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

		heterogjene) – Legura – Dekantimi – Filtrimi – Distilimi – Kristalizimi (nga tretja)	– Eksperimentimi – Demonstrimi	
--	--	-----------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------------	--

Njësia modulare 3: SISTEMI PERIODIK I ELEMENETEVE (5 orë)				
Nr. rendor	Rezultatet nga të mësuarit	Përmbajtjet dhe nocionet	Aktivitetet dhe metodat	Kriteret e vlerësimit *
1	<p><b>Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë të:</b></p> <p>-përshkruajë strukturën e tabelës së sistemit periodik të elementeve duke përdorur nocionet për periodë dhe grup;</p>	<p><b>Përmbajtjet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Struktura e tabelës së sistemit periodik të elementeve</li> </ul> <p><b>Nocionet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sistemi periodik i elementeve</li> <li>- Periodat</li> <li>- Grupet</li> </ul>	<p><b>Aktivitetet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Diskutimi për strukturën e tabelës së sistemit periodik të elementeve.</li> <li>- Prezantimi llojeve të ndryshme të tabelave të klasifikimit të elementeve.</li> <li>- Ushtrime: gjetja e të dhënave për një element të caktuar nga tabela e sistemit periodik të (simbolin kimik, përkatësia në një grup ose periodë të caktuar etj.).</li> <li>- Prezantimet: jeta dhe</li> </ul>	<p><b>Nxënësi/nxënësja mund të:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përshkruajë tabelën e sistemit periodik të elementeve si mënyrë e klasifikimit të elementeve;</li> <li>- dallojë grupet nga periodat dhe njohë shënimin e tyre;</li> <li>- kuptojë ligjshmërinë periodike të elementet kimike;</li> <li>- shfrytëzojë të dhëna për elementet nga tabela e sistemit periodik të elementeve;</li> </ul>

\* Janë vendosur standarde/indikatorë për arritjen e rezultateve nga të mësuarit në bazë të të cilave përcaktohen kriteret e vlerësimit.

			<p>vepra e shkencëtarëve kimistë të njohur (Dimitrij Mendeleev, Johan Volfgang Deberajner, Xhon Njulends, Henri Mozli etj.).</p> <p><b>Metodat:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Diskutimi</li> <li>– Prezantimi</li> <li>– Demonstrimi</li> <li>– Ilustrimi</li> </ul>	
2	- lidhë strukturën e atomit të elementit dhe vendin e tij në tabelën e sistemit periodik;	<p><b>Përmbajtjet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Sistemi periodik i elementeve dhe ndërtimi i atomit</li> </ul>	<p><b>Aktivitetet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Diskutimi për lidhshmërinë e strukturës së atomit të elementit dhe vendi i tij në tabelën e sistemit periodik të elementeve.</li> <li>– Ushtrimet:</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– bëjë dhe sqarojë lidhjen mes numrit të grupit në të cilin gjendet elementi dhe numrin e elektroneve valente në atomin e elementit;</li> <li>– bëjë dhe sqarojë lidhjen mes numrit të periodes në të cilën gjendet elementi dhe numrit të shtresës elektronike në të cilën gjenden elektronet</li> </ul>

			<p>Përcaktimi i vendit të elementit në tabelën e sistemit periodik të elementeve në bazë të ndërtimit të atomit të tij dhe anasjelltas.</p> <p><b>Metodat:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Diskutimi</li> <li>– Llogaritja</li> </ul>	<p>valente të atomit të elementit;</p>
3	<p>- njohë dhe sqarojë trendin e ndryshimeve periodike të vetive metalike/jo metalike përgjatë periodës dhe përgjatë grupit.</p>	<p><b>Përmbajtjet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Periodizimi i vetive metalike/jo metalike</li> </ul>	<p><b>Aktivitetet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Prezantimi i ndryshimit periodik të vetive të metaleve/jometaleve përgjatë periodave dhe përgjatë grupit.</li> <li>– Ushtrimi: Analiza e të dhënave dhe klasifikimi i substancave elementare me veti të njëjta.</li> </ul> <p><b>Metodat:</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– përshkruajë ndryshimin nga vetitë metalike në jo metalike përgjatë një periode të caktuar;</li> <li>– ndjekë ndryshimet periodike të vetive metalike/jo metalike përgjatë grupit.</li> <li>– përshkruajë dhe sqarojë lidhjen mes numrit të grupit, numrit të elektroneve valente dhe vetive metalike/jo</li> </ul>



			<ul style="list-style-type: none"><li>- Prezantimi</li><li>- Diskutimi</li><li>- Ilustrimi</li></ul>	<p>metalike;</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- parashikojë vetitë e substancave elementare (metaleve, jometaleve) në bazë të vendndodhjes së elementeve në tabelën e sistemit periodik.</li></ul>
--	--	--	------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Njësia modulare 4: LIDHJET KIMIKE (7 orë)				
Nr. rendor	Rezultatet nga të mësuarit	Përmbajtjet dhe nocionet	Aktivitetet dhe metodat	Kriteret e vlerësimit*
1	<p><b>Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë të:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- definojë lidhjen dhe prezantojë me paraqitje skematike krijimin e lidhjes jonike.</li> </ul>	<p><b>Përmbajtjet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lidhja jonike</li> <li>- Vetitë e komponimeve të nderuara jonike</li> </ul> <p><b>Nocionet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Jon</li> <li>- Kation</li> <li>- Anion</li> <li>- Lidhja jonike</li> <li>- Simbolet e Luisit</li> <li>- Forcat elektrostатike</li> <li>- Grila jonike e kristaltë</li> </ul>	<p><b>Aktivitetet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Diskutimi për krijimin e lidhjeve jonike.</li> <li>- Ushtrime: prezantim skematik të krijimit të lidhjes jonike nëpërmjet shembujve të ndryshëm.</li> <li>- Ushtrime: studimi i komponimeve të ndërtuara jonike.</li> </ul> <p><b>Metodat:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Diskutimi</li> <li>- Ilustrimi</li> </ul>	<p><b>Nxënësi/nxënësja mund të:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- definojë nocionet: jon, kation dhe anion;</li> <li>- bëjë dallim mes kationeve dhe anioneve;</li> <li>- sqarojë mënyrat e krijimit të jonit (kationit dhe anionit) dhe lidhjes jonike;</li> <li>- shkruajë simbolet e Luisit dhe t'i zbatojë drejtë gjatë prezantimit të krijimi të lidhjes jonike;</li> <li>- sqarojë vetitë e komponimeve të ndërtuara jonike;</li> </ul>

\* Janë vendosur standarde/indikatorë për arritjen e rezultateve nga të mësuarit në bazë të të cilave përcaktohen kriteret e vlerësimit.

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Njësi e formulës</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Prezantimi</li> <li>- Eksperimentimi</li> </ul>	
2	<p>- definojë lidhjen kovalente, njohë lidhjen kovalente polare dhe jo polare dhe prezantojë me paraqitje skematike krijimin e lidhjes kovalente.</p>	<p><b>Përmbajtjet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lidhja kovalente polare dhe jo polare</li> <li>- Vetitë e substancave të krijuara në mënyrë kovalente</li> </ul> <p><b>Nocionet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lidhja kovalente (jo polare dhe polare)</li> <li>- Çifti elektronik</li> <li>- Lidhja e njëfishtë</li> <li>- Lidhja e dyfishtë</li> <li>- Lidhja e trefishtë</li> <li>- Formulatat e Luisit</li> <li>- Elektronegativiteti</li> </ul>	<p><b>Aktivitetet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Diskutimi për krijimin e lidhjes kovalente.</li> <li>- Ushtrimet: prezantimi skematik i krijimit lidhjes kovalente jo polare dhe polare nëpërmjet shembujve të ndryshëm.</li> <li>- Ushtrimet: studimi i vetive të substancave kovalente.</li> </ul> <p><b>Metodat:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Diskutimi</li> <li>- Ilustrimi</li> <li>- Prezantimi</li> <li>- Eksperimentimi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- definojë dhe dallojë lidhjen kovalente jo polare dhe polare;</li> <li>- definojë elektronegativitetin dhe ta lidhë me lidhjen kovalente;</li> <li>- shkruajë simbolet dhe formulatat e Luisit dhe drejtë t'i zbatojë gjatë prezantimit të lidhjes kovalente;</li> <li>- njohë dhe bëjë dallim, mes lidhjes së njëfishtë, dyfishtë dhe trefishtë;</li> <li>- sqarojë vetitë e substancave të nderuara në mënyrë kovalente;</li> <li>- bëjë dallim mes substancave jonike dhe kovalente dhe krahasojë vetitë e tyre.</li> </ul>

Njësia modulare 5: GRUPET THEMELORE TË KOMPONIMEVE INORGANIKE (22 orë)

Nr. rendor	Rezultatet nga të mësuarit	Përmbajtjet dhe nocionet	Aktivitetet dhe metodat	Kriteret e vlerësimit*
1	<p><b>Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë të:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- definojë dhe klasifikojë oksidet; zbatojë nomenklaturën për oksidet; t'i njohë dhe përshkruajë vetitë e oksideve dhe mënyrat e përfitimit të tyre;</li> </ul>	<p><b>Përmbajtjet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nocioni për okside dhe nomenklatura e oksideve</li> <li>- Ndarja e oksideve (sipas përbërjes dhe vetive)</li> <li>-Mënyra e përfitimit të oksideve</li> <li>- Vetitë e oksideve</li> </ul> <p><b>Nocionet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Oksidi</li> <li>-Oksidi metalik</li> <li>- Oksidi jometalik</li> <li>-Oksidi acidik</li> <li>- Oksidi bazik</li> <li>- Oksidi atmosferik</li> </ul>	<p><b>Aktivitetet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Diskutimi në lidhje me nocioni oksid</li> <li>- Ushtrime për njohjen e oksideve, për emërtimin e oksideve dhe përpilimin e formulave të oksideve.</li> <li>-Ushtrime për mënyrat e ndryshme të klasifikimit të oksideve me zbatimin e tabelës së sistemit periodik dhe fletëve të punës.</li> <li>- përpilimi i tabelave për klasifikimin e oksideve dhe diskutimi rreth mënyrave të ndryshme të klasifikimit.</li> <li>- Ushtrimet: vërtetimi i përkatësisë së oksidit në klasën e acideve acidike gjegjësisht bazike në bazë të reaksionit</li> </ul>	<p><b>Nxënësi/nxënësja mund të:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- definojë dhe sqarojë nocionin oksid;</li> <li>-numërojë oksidet të cilat hasen në natyrë dhe jetën e përditshme;</li> <li>- njohë oksidet sipas formulës;</li> <li>- emërtojë oksidet në bazë të formulës së dhënë;</li> <li>-përpilojë formulë të oksidit mbi bazën e emrit të njohur;</li> <li>- klasifikojë okside si oksidet e metaleve dhe jometaleve sipas përbërjes kimike;</li> <li>- klasifikojë oksidet si acidike, bazike dhe amfotere, sipas vetive</li> </ul>

\* Janë vendosur standarde/indikatore për arritjen e rezultateve nga të mësuarit në bazë të të cilave përcaktohen kriteret e vlerësimit.

		<p>- Oksidi indiferent (neutral)</p>	<p>të tij me ujin.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Eksperimentet demonstruese për përfitimin e disa oksideve.</li> <li>- Eksperimentet demonstruese dhe/ose eksperimentet në grupe të vogla për vetitë kimike të oksideve.</li> <li>- Ushtrime për shkrimin e barazimeve të reaksioneve të oksideve.</li> </ul> <p><b>Metodat:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Diskutimi</li> <li>- Demonstrimi</li> <li>- Vëzhgimi</li> <li>- Eksperimentimi</li> <li>- Mësimi nëpërmjet hulumtimit</li> </ul>	<p>tipike të secilës klasë;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-shënojë me barazim të reaksionit kimik mënyrat e ndryshme për përfitimin e oksideve;</li> <li>- shkruajë barazime për reaksionet karakteristike të oksideve;</li> <li>-lidhë vetitë e oksideve me zbatimin e tyre;</li> </ul>
